




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, kk.rks-gov.net/gjilan, info.gjilan@rks-gov.net tel. 0280 320 781, 0280 320 782, 321 482, 321 483

Procesverbal

I mbajtur më datë **27.12.2012**, (e enjte) me fillim në ora **11:00**, në Seancën solemne të Kuvendit të Komunës së Gjilanit në përmbyllje të vitit 2012

Kryesuesi i Kuvendit
Izmi Zeka

Të pranishëm në Seancë solemne ishin;
Anëtarët e Kuvendit
Kryetari i Komunës, z. Qemajl Mustafa
Zv/kryetari i Komunës, z. Omer Daku
Zv/kryetari i Komunës për minoritete, z. M. Stojanović
Përfaqësuesi i OSB-së Basri Sejdiu
Mediet

Seancën solemne e hapi kryesuesi i Kuvendi z. Izmi Zeka i cili së pari kërkoi nga sekretaria që të verifikojë prezencën e anëtarëve të Kuvendit në këtë seancë solemne.

Pas ftesës që i bëri anëtarëve të Kuvendit, sekretaria konstatoi se në këtë seancë janë të pranishëm 36 anëtarë, kurse munguan 5 (Arben Mehmeti, Ramiz Ramadani, Selim Selimi, Leonorë Bunjkau, Enver Hajrullahu).

I pari e mori fjalën shefi i Shërbimit të Kuvendit, z. Sadri Arifi i cili së pari i dëshiroj mirëseardhje dhe i përshëndeti të gjithë anëtarët e Kuvendit, kryetarin e Komunës, mediet, OJQ të, në veçanti OSB-në e cila gjatë tërë vitit ka qenë së bashku me ne dhe ka dhënë një kontribut të madh në avancimin e proceseve demokratike në Komunë. Duhet theksuar se gjatë këtij viti puna e Kuvendit ka qenë me plotë dinamizëm dhe kemi mbajtur 11 seanca të rregullta në të cilat seanca i kemi aprovuar 72 vendime e që i bie mesatarisht nga 6 vendime për çdo seancë, por i kemi miratuar edhe 4 rregullore. Në bazë të këtyre të dhënave mund të konstatojmë se Kuvendi ka qenë mjaft efikas dhe ka qenë një klimë shumë e mirë edhe politike dhe ndër njerëzore. Unë i falënderoj për kontribut të gjithë, kurse së pari fjalën do ta ketë kryesuesi i Kuvendit, mandej kryetari i Komunës.

Izmi Zeka- kjo është një seancë përmbyllëse dhe ne kemi ftuar këtë seancë për të dëshmuar se KK i Gjilanit e ka ruajtur gjatë tërë këtij viti, por edhe gjatë viteve të mëparshme e ka ruajtur një disponim shumë demokratik. Gjatë tërë kohës ka mbretëruar edhe një frymë konsensuale dhe një frymë e debatit e cila frymë mungon në

kuvendet e tjera të Kosovës dhe të vendeve të tjera në rajon. Me të drejtë është thënë se Gjilani e ka tejkaluar vitin 1999, i ka tejkaluar ato ngjyrimet e ngushta, sepse ka arrit shumë në ngritje të kapaciteteve demokratike. Kjo frymë dhe ky disponim e ka bërë KK-në shumë më të dinjitetshëm, më të mirë dhe më profesional. Ne kemi pasur edhe debate të natyrave të ndryshme, por e tëra kjo ka qenë në suaza normale dhe të punës, sepse të gjithë kemi qenë të interesuar që të ecim me procese sa më shpejtë.

Pjesë qenësore e këtij Kuvendi janë edhe drejtoritë të cilat e bëjnë punën dhe që shihet në terren. Kjo seancë solemne e ka edhe një konotacion tjetër dhe jo rastësisht ne do t' i ndajmë edhe disa mirënjohje. Ka qenë 100 Vjetori i Pavarësisë së Shqipërisë i cili ka konciduar që ne të jemi pjesë e këtij 100 Vjetori. Do të ishte jo korrekte në nëse ne në këtë moment mos ta kthejmë kohën pak prapa ose të mos rikthehemi për të parë historinë se nga kanë kaluar shqiptarët dhe si kanë ardhur në këtë fazë?

Historia e Shqipërisë dhe e Kosovës nuk janë të ndara, por janë ngjarje të përbashkëta dhe ka ardhur deri te dita e sotme. Tani i kemi dy shtete, por megjithatë është një identitet i përbashkët dhe një identitet kombëtar i përbashkët. Ajo Shqipëri e vitit 1912, për 100 vjet neve na ka mbajtur në kontinuitet për të ardhur deri te shpallja e Pavarësisë së Kosovës.

Unë iu uroj sinqerisht që KK i Gjilanit të vazhdojë punën edhe vitin e ardhshëm në këtë mënyrë dhe uroj që në fund të vitit të jeni mirë me shëndet ju personalisht dhe familjet e juaja, duke dëshiruar që vitin e ardhshëm të punojmë edhe më mirë dhe të jemi më efikas në mënyrë që Gjilani të jetë qytet edhe më ndryshe në të mirë të qytetarëve të tij. Urime ky vit, suksese në familje tuaja dhe i uroj suksese të gjithë qytetarëve të Gjilanit!

Qemajl Mustafa- e nderuara kryesi e KK-së, të nderuar këshilltarë, të drejtuar drejtorë, e nderuara sekretari e Kuvendit dhe të nderuar ju monitorues dhe vëzhgues të punës së Kuvendit të KK-së dhe të nderuara medie, më lejoni që t' i përshëndes sot në këtë përmbyllje të punës së Kuvendit për vitin 2012.

Më lejoni që t' iu shpreh mirënjohje dhe falënderime të gjithë atyre që theksova më lartë, por në veçanti këshilltarëve të Kuvendit të cilët me angazhimin e tyre profesional e politik e ndihmuan shumë kryetarin e Komunës, e ndihmuan qeverisjen, por edhe e korrektojnë atë nëse kjo në ndonjë rast kërkohej. Unë e çmoj punën e secilit prej juve të të gjitha grupeve politike dhe kryesuesve të këtyre grupeve, por në veçanti e çmoj angazhimin e përhershëm, konstruktiv, tolerant e fer dhe në shumicën e rasteve edhe profesional të grupeve politike në opozitë e që është grupi i LDK-së dhe ai i AAK-së.

Kemi qenë shembull më tipik në komunat e Kosovës se si bëhet qeverisje e mirë dhe avancohet demokracia përmes koncenzuesit demokratik dhe sjelljes plotësisht demokratike dhe ligjore.

Konstatoj me kënaqësi sot se siguria në Komunën tonë është e lartë dhe në rritje të përhershme duke e falënderuar Policinë e Kosovës, KFOR-in Amerikan, Drejtorin për Mbrojtje dhe Shpëtim, por para së gjithash duke i falënderuar qytetarët tanë për bashkëpunim dhe angazhim të mirë në ruajtjen e klimës së sigurisë në ruajtjen e jetës dhe pasurisë së Komunës. Konstatojmë gjithashtu me kënaqësi se ambienti politik e shoqëror është i mrekullueshëm në Komunën tonë dhe kemi komunikim të shkëlqyer të hapur dhe të lirshëm në mes subjekteve dhe grupeve politike në Kuvend.

Ajo çka është edhe më me rëndësi kemi marrëdhënie tejet të mira ndëretnike dhe ndër njerëzore. Ky është një kontribut i madh i të gjithë neve pa dallim edhe pse

përgjegjësitë e mëdha i takojnë atyre që qeverisin. Ky ambient i mirë ka bërë që ne të qeverisim në kushte plotësisht normale edhe pse ky vit ndjeshëm dallohet për nga ngushticat financiare të cilat e përcollën këtë vit. Pavarësisht kësaj kanë filluar, përfunduar dhe janë në fazën e zbatimit me dhjetëra projekte të vlefshme të infrastrukturës për përmirësimin e jetës së qytetarit tonë.

I falënderoj drejtorët, menaxherët e zyrave dhe sektorëve, shërbyesit civil në administratë dha ata profesional në arsim dhe shëndetësi për angazhim të shtuar dhe të përditshëm në realizmin e synimeve tona. Puna e pakursyer e tyre dhe monitorimi dhe korrektimi dhe vendimmarrja në Kuvend dhe në trupat e tij (në komitetet) ka bërë që sot të jemi komunën e spikatur si nga vlerësuesit vendorë ashtu edhe ata ndërkombëtar.

Nuk kam asnjë dilemë se kështu bashkë do të festojmë dhe urojmë këtë vit për rezultate të mira të Komunës dhe të vazhdojmë bashkë që ta zhvillojmë qëndrueshëm dhe gjithanshëm Komunën në vitin që vjen. Jemi munduar edhe sivjet sikur çdo vit tjetër të sjellim më shumë dritë dhe dekor në qytet që të kemi më shumë entuziazëm dhe atmosferë festive. Uroj që të kënaqemi bashkë në këtë atmosferë dhe edhe njëherë për fund ju falënderoj të gjithëve për angazhim dhe GËZUAR festën e ndërrimit të moteve.

Në vijim të kësaj seance solemne nga disa fjalë përshëndetësi në prag të ndërrimit të moteve i thanë edhe shefat e grupeve parlamentare të PDK-së, LDK-së dhe AAK-së.

Gjithashtu edhe zv/kryetari për komunitete z. Millan Stojanović i tha disa fjalë përshëndetëse për këtë fund vit. Z. Stojanović e përshëndeti kryetarin e Komunës, kryesuesin e Kuvendit, anëtarët e Kuvendit, drejtorët e drejtorive dhe të gjithë të tjerët duke i dëshiruar një vit sa më të frytshëm dhe të begatshëm.

Mirëpo sa i përket investimeve dëshiroj që të ketë më shumë investime, sepse disa gjëra po ndodhin shumë shpejtë dhe unë kam bërë ftesë që të formohet në lob shqiptaro-serb për të pasur mundësi që Gjilani të hyjë në Evropë. Ne në vitin e ardhshëm duhet të orientojemi kah qytetarët tanë dhe duhet ta ngrinim zërin edhe kundër Beogradit dhe kundër Prishtinës dhe duhet t' i themi edhe Thaçit dhe Daçiqit se prioritet i të gjitha prioritetet është auto udha Bujanoc- Gjilan. Gjithashtu në vitin tjetër zonja nga LDK, duhet të jetë pak më guximshme dhe mos të shikoj vetëm interesat e Qeverisjes Qendrore, por të interesohet pak më tepër për Anamoravën

Nëse i kthehem së kaluarës këta njerëz edhe para luftës dhe pas luftës këta kanë qenë më të kulturuarit, më të ndershmit, më të qëndrueshmit, por duhet edhe pak ta ngrinim zërin edhe kundër Beogradit dhe kundër Prishtinës, kurse në anën tjetër mos ta lëndojmë askënd, kurse në anën tjetër të kërkojmë që Anamorava të ketë kushte më të mira. Për mua prioritet i të gjitha prioritetet është Anamorava.

Faleminderit dhe urime ky vit!

Në përfundim të seancë solemne të gjithë anëtarëve të Kuvendit nga ana kryetarit të Komunës iu nda nga një mirënjohje për punën dhe rezultatet e arritura gjatë vitit kalendarik 2012.

Procesmbajtësi

Sali HASANI

Kryesuesi i Kuvendit

Izmi ZEKA